



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Nr. 03-355

17.11.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 14 të Ligjit për Media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr.184/13 dhe 13/14), pika 6 e Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacionin në dispozicion të përdoruesve, ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, pika 7 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3880 /1 datë 26.10.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 37-të mbajtur me datë 16.11.2023, në pajtim me Konkluzionin nr. 02-4225/3 datë 16.11.2023 miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Ndërmarrja Publike Radiodifuzive (NPR) RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë Programor (TVM3), për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media, të mënyrës që më 4 tetor 2023, në pjesë të programeve të transmetuara, nuk ka publikuar të dhënat që është i detyruar t'i transmetojë në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3880/1 datë 26.10.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi si Shtojcë nr.1.

2. DETYROHET NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë Programor (TVM3) në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë e miratimit llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Arsyetim

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia), në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe neni 29 të Ligjit për Media (LM), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të veprimtarisë së botuesve të medias, nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me detyrimet nga nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur është konstatuar mos respektim, shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimevetë përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si organ rregullator kompetent mund t'i ndërmarë, dhe që janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen gjithashtu dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 14 të LM, botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo bartës individualisht të përmbajtjes (për shembull, mostër e medias së shkruar dhe emisioni televiziv) të sigurojë publikimin e të dhënave në vijim: emrin dhe adresë të selisë dhe redaksisë të botuesit të medias, emri i personit përgjegjës të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës, pra redaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emrin dhe adresën e shtypshkronjën dhe datën e botimit ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të botura (shtypura), në rastin e mediumi të shtypur. Për transmetuesit, detyrimi i lartpërmendur zbatohet në atë mënyrë që të dhënat të publikohen në fillim ose në fund të programeve audio/audi vizuale. Botuesi i medias është i detyruar në vendin e duhur për çdo përmbajtje të publikojë këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin e autorit të shtojcës së publikuar, emrin dhe mbiemrin e personit, gjegjësisht të firmës që ka të drejtën e autorit për përmbajtjet e publikuara, përveç atyre të shtypura dhe programeve në radio, data e produksionit (muaji dhe viti) nëse kemi të bëjmë me vepër audio/audi vizuale, origjina e veprës audio/audi vizuale, dhe nëse vepra është krijuar nga produksion i pavarur dhe informacioni për të, emri i personi juridik, gjegjësisht emri dhe mbiemri i personit që e ruan atë të mirën kulturore ose vepër arkivore të përdorur, gjegjësisht riprodhimin e duhur dhe emrin e botuesit të medias nga ku është marrë shtojca e programit ose klipi nga shtojca (bashkëngjitja) e programit, përveç nëse me marrëveshje të ndërsjellë nuk është rregulluar ndryshe.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimi për përmbushje të detyrimit për impresium dhe informacionin në dispozicion të përdoruesve, ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, tek programet e tjera të prodhimit vendor, impresium publikohet ashtu që: në shpicën lajmëruese dhe çlajmëruese publikohen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të shërbimit programor; emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të redaksisë nga ku buron programi (nëse ka); emri dhe mbiemri i redaktorit/autorit/prezantuesit të emisionit; emri dhe mbiemri i bashkautorëve, gjegjësisht të të gjithë ekipit realizues pjesëmarrës në tërësinë e veprës audi vizuale; titulli i subjektit që ka prodhuar programin (vetë transmetuesit, bashkëprodhuesit, producentin e pavarur si porositës i programit) dhe datën e produksionit (muaj dhe vit). Nëse është e nevojshme duhet të publikohen dhe të dhëna për: emrin e personit juridik, gjegjësisht emri dhe mbiemri i personit që e ruan të mirën kulturore ose veprën arkivore, gjegjësisht reproduksionin e veprës dhe emrin e subjektit tjetër nga ku është ndërmarrë pjesë e caktuar e shtojcës ose pjesë e bashkëngjitjes, vetëm nëse me marrëveshje të ndërsjellë nuk është rregulluar ndryshe.

Agjencia, në kuadër të kompetencave të saj ligjore, nëpërmjet Sektorit për çështje programore më 26 tetor 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative ndaj shërbimit programor televiziv të NPR TELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë Programor (TVM3) transmetuar më 4 tetor 2023 në nivel shtetëror, në të cilin ka konstatuar shkelje të nenit 14 të LM. Gjegjësisht, nga mbikëqyrja është konstatuar se në pjesë të programeve të transmetuara më 4 tetor 2023, nuk janë publikuar të dhënat që identifikojnë autorët që kanë marrë pjesë në përgatitjen e përmbajtjeve audi vizuale, për bartësin e të drejtës autoriale, për redaktorin/redaktorët përgjegjës të programeve, për origjinën dhe datën e produksionit të veprës audi vizuale, emrin e mediumit nga ku është marrë përmbajtja etj, që radiodifuzeri është i detyruar t'i transmetojë në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor. Në kundërshtim me pikën 6 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacionin në dispozicion të përdoruesve, gjatë reprizave të transmetuara të ndeshjeve sportive dhe transmetimeve nga garat kombëtare dhe evropiane, si në shpicën lajmëruese dhe në shpicën çlajmëruese nuk janë publikuar në tërësi të dhënat për impresium – ekipin realizues autorët, të dhënat editoriale dhe data e produksionit.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me Shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3880/1 datë 26.10.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV Këshilli i Agjencisë drejtuar NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i maqedonisë - Shërbimi i tretë programor (TVM3), më 27.10.2023 ka dërguar Shkresë nr.y në 10-3880/2 datë 27.10.2023, ku dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3880/1, datë 26.10.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzojë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresa u pranua në mënyrë

të rregullt nga transmetuesi më 30.10.2023, dhe në afatin e parashikuara NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i maqedonisë – Shërbimi i tretë programor (TVM3), ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitat nga LM, ark.nr.14-6053/2 datë 08.11.2023 (nr ynë ark.10-3880/3 datë 13.11.2023). Keshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 16.11.2023, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim dhe konkludoi që NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i maqedonisë - Shërbimi i tretë programor (TVM3), t'i shqiptoi masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 të LM, pika 6 e Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacioneve në dispozicion të përdoruesve, pika 7 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022 dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3880/1 datë 26.10.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LM, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 37-të mbajtur më 16.11.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-4225/3 datë 16.11.2023, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë Programor (TVM3), dhe detyrohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në bazë të nenit 24 paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi botuesi i medias së shkruar ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-3880/1 datë 26.10.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI,d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.